Kori i femrave është ansambël vokal, i cili përbëhet nga zërat e femrave të moshës së ritur – sopranit, mezosopranit dhe altit. Mund të interpretojë kompozime njëzërëshe, dyzërëshe, trizërëshe dhe katërzërëshe.

Kori i femrave mund të ketë tingëllim masiv dhe të fuqishëm, por edhe tingëllim lirik dhe të ndjeshëm.

Në regjistrat e sipërm vjen në shprehje ngjyra e çiltër dhe e fuqishme e zërit të sopranit, kurse në regjistrat e ulët, dukshëm vërehet ngjyra e errët dhe dramatike e altit.

Vëllimi i zërit tek këngëtarët si dhe vokali dhe kapaciteti i formuar i zërit, japin mundësi për t'u realizuar kompozime të karaktereve dhe zhanreve të ndryshme.



Kori i femrave.



Mbaj në mend!

1. Kori i femrave është i përbërë nga zërat e femrave.

Trajko Prokopiev “Vuajtje”

Trajko Prokopiev

Trajko Prokopiev (1909 – 1979), kompozitor dhe dirigjent, ka qenë njëri nga organizatorët më të spikatur të jetës muzikore në Maqedoni.

Rruga e zhvillimit të krijimtarisë së tij fillon me përpunimin e këngëve popullore dhe të kompozimeve korale, të cilat e mbajnë emrin e qytetit të tij , të quajtura si “ Kumanovka”. Mundësitë e reja të të shprehurit i gjen tek veprat kamertale, baleti “ Labini dhe Dojrana” si dhe tek opera e tij “ Ndarja”.

Në veprimtarinë e tij kompozicionale, një vend i rëndësishëm i takon muzikës së filmit edhe ate për filmat : “ Frosina “ dhe “ Nata e ujqërve”.

Në veçanti njihet për krijimtarinë e muzikës korale maqedonase. Në këtë pjesë të krijimtarisë së tij, është prezente gjuha origjinale dhe autentike e frymës popullore. Ka fituar një numër të madh të çmimeve dhe lëvdatave, ndër të cilat do t’i përmendim çmimin 11 Tetori, Çmim për vepër jetësore etj.

Inspirimi për kompozimin koral “ Gurbeti” , është gjendja e vështirë e popullit maqedonas në periudhën e sundimit turk.

Bazamenti tekstual i këtij kompozicioni është kënga me të njëjtin emër e Koço Racinit. Melodia e mbushur me dramaticitet dhe emocione, e reflekton gjendjen dhe jetën e vështirë të popullit, realitetin pa jetë të mirë për njerëzit, pa dashuri, pa ditë të ndritshme, por vetëm vështirësi dhe vuajtje të një jete argati dhe të shtypuri.



Qendra për kulturë në Kumanovë
“ Trajko Prokopiev”

Vuajtje

Muzika : Trajko Prokopiev

Teksti: Koço Racin



Не-ма ли жи-вот не-ма ли љу-бов за жи-----вот го - ле - ма

A nuk ka jetë, a nuk ka dashuri për njeriun



љу-бов за жи-вот чо-веч-ка у - ви - ја гра-----ди ар - гат - ски

A nuk ka shpresë, për atë që bën jetë argati

Нема ли живот, нема ли љубов голема,
Љубов за живот човечка, у вија гради аргатски.
Нема ли срце на срца широко, срце длабини длабоко,
Цел свет да разбере, па да е за вија гради малечко.
Нема ли бел ден, ден да е на деновите, ден да е на аргатите.
Ден сонце вишен високо, ден море ширен широко.
Сонце да запре, да стои и времето зачудено.
Срцето пука обрачи и плиска знаме алово.
Срцето што се отвара, и шири широко широко.
Целиот свет да загрне.
Нема ли живот, нема ли љубов за живот голема.

A nuk ka jetë, a nuk ka dashuri për njeriun
A nuk ka shpresë, për atë që bën jetë argati
A nuk ka zemër të gjerë për njeriun e vuajtur
A nuk ka ditë të ndritshme për te.
A nuk ka zemërgjerësi dhe mirësi,
Ndër njerëz dhe në botë,
A nuk ka jetë, a nuk ka dashuri për njeriun,
Që vuan dhe që kurë dritë nuk shohin,
A nuk ka shpresë për atë që bën jetë argati,
A nuk ka më zemra të gjëra në këtë botë,
Ngushëllim dhe dashuri ,
Për njeriun e vuajtur dhe të pashpresë,
Për njeriun që bën jetë të pa jetë.



Detyra:

1. Emërto llojin e korit.
2. Gjeji elementet folklorike në këtë kompozim.
3. A kanë ndikim , ndryshimet dinamike të këtij kompozicioni, në përjetimin tënd, sa i përket karakterit të pjesës?

Kori i meshkujve

Kori i meshkujve është ansambël vokal, i cili përbëhet prej zërave të meshkujv, të moshave të rritura: tenor, bariton dhe bas.

Ky kor ka tingëllim më masiv, më të errët dhe më të fuqishme. Është shumë i përshtatshëm për të shprehur disponime dramatike, heroike dhe luftarake. Tingëllimi i errët, si shprehje e karakteristikave specifike të zërave, jep përshtypjen e qëndrueshmërisë dhe fuqisë.

Në repertoarin e koreve të meshkujve marrin pjesë kompozime njëzërëshe, dyzërëshe, trizërëshe dhe katërzërëshe.



Kori i meshkujve



Mbaj në mend!

Kori i meshkujve përbëhet prej zërave të meshkujve.

K.M. Ueber “ Kori i gjuetarëve” nga opera “
Shigjetari magjik”.

Karl Marija von Ueber

Karl Marija Fridrih Ernest von Ueber (1786 – 1826), është njëri nga kompozitorët e shquar gjerman, dirigjent dhe pianist.

Ai krijoi në periudhën dhe stilin e romantizmit, periudhë kjo, e cila në kulturën muzikore përjetoi një nga zhvillimet më të mëdhaja të të gjitha epokave muzikore.

Liria në krijimtarinë artistike, përdorimi i flklorit muzikor, përshkrimet e natyrës, ndjenjat si dhe përjetimet, kulturës muzikore në Evropë i dhanë një fizionomi të re.

Sipas shembullit të kompozitorëve shumë të njohur të asaj kohe: Gjyzepe Verdi, Xhoakino Rosini, Gaetano Donixeti, Rikard Vagner, Zhorzh Bize, si dhe shumë e shumë kompozitorë të tjerë, të cilët dhanë një kontribut të madh për zhvillimin e operës, Ueberi e krijoi operën nacionale gjermane.

Në periudhë të caktuar, Karl Marija von Ueber, ishte drejtor i operës. Më vonë punoi si udhëheqës i operës mbretërore në Drezden.

Krijimtaria e tij përbëhet nga një numër i madh i operave, muzikë spirituale, pjesë orkestrale dhe muzikë kamertale. Njëra nga operat e tij më të rëndësishme është “Shigjetari magjik”, operë në tri akte e cila është e shkruar në gjuhën gjermane. Libretoja (teksti) i operës është inspiruat nga një proverbë popullor.

Në ditët e sotshme, opera “Shigjetari magjik” konsiderohet si njëra nga opera e para që i përkasin periudhës së romantizmit.

Pas premierës së saj në Berlin kjo operë korri një sukses shumë të madh.



Skenë nga opera Shigjetari magjik.

Kori i gjuetarëve nga opera “ Shigjetari magjik”

Ngjarja ndodh në Çeki, pas luftës tridhjetëvjeçare, aty nga viti 1648.

Personazhi Maks është i dashuruar tek Agata, e cila është vajza e pylltarit Kuno. Ai dëshiron që ta trashëgojë dhe ta marrë Agatën për grua. Për t’iu plotësuar kjo dëshirë, Maksi duhet që të fitojë në garën e shigjetave. Kaspari, njëri nga gjuetarët, i’a ka shitur shpirtin e tij keqbërës, gjarpërit Zamijel. Ai e bind Maksin që në garë të përdorë shigjeta magjike. Maksi e pranon këtë propozim. Në vendin e ngjarjes, Kaspari përgatit shtatë shigjeta ku shigjetën e fundit do ta gjuajë sipas dëshirës së Zamijelit. Maksi nuk kishte njohuri për këtë plan të tij.

Agata përgatitet për dasmën me Maksin. Është e shqetësuar për shkak të mundimeve të mbrëmjes.

Maksi, duke i përdorur të gjashtë shigjetat magjike, fiton. Udhëheqësi e urdhëron Maksin që me shigjetën e shtatë të gjuaj në pëllumbin e bardhë. Maksi gjuan, pëllumbi fluturon kurse Agata bie në tokë duke mos dhënë shenja për jetë. Një njeri i ndihmon që të vetëdijësohet.

Menjëherë përhapet lajmi që Kaspari është i vdekur, i vrarë nga Zamijeli i marrë. Maksi i penduar pranon se veprimi i tij është pjesë e planit të Kasparit.

Njeriu që ndihmoi e bind udhëheqësin që Maksit t’i shqiptohet një dënim simbolik.

Epilog: Lajmërohet martesë e Maksit dhe Agatës pas një vit.

Kori i gjuetarëve

Me fytyra të qeshura, a do të del agimi
Në fusha me pyje shkojmë për në gjah,
Sa dëgjojmë trubën, trishtimi na kaplon,
Zemrat seç na dridhen nga zëri i tij i fortë
A do të vijë drenusha , apo dreri do kalojë
Që të bëhen ato, pjesë e gjuetisë sonë
Sa të bjer erësira, mbi qiellin që na mbulon
Do shkojmë për verë të gjithë tok.

Refreni: la la la la



Detyra:

1. Emërto llojin e interpretimit në këtë vepër muzikore.
2. Këndo melodinë e “ Korit të gjuetarëve” me përdorimin e nuancave dinamike.

Kori i përzier

Dy koret e bashkuara : kori i femrave dhe kori i meshkujve e përbëjnë korim e përzier. Ai paraqet ansamblin më masiv vokal, me një kolorit shumë të pasur dhe me një tingëllim të fuqishëm.

Ka një potencial shumë të madh për të shprehur përmbajtje të ndryshme literaturo – muzikore. Kori i përzier ka më tepër mundësi shprehëse për dallim nga kori i femrave dhe kori i meshkujve.




Detyrë:

1. Cilët lloje të zëreve marin pjesë në korin e përzier?
2. Sqaro, përse kori i përzier jep më shumë mundësi shprehëse për dallim nga kori i femrave dhe kori i meshkujve?

Dragan Shuplevski – “ Rum – dum – dum”

Dragan Shuplevski

“ Rum – dum – dum”



Зур - ли треш-тат над сред се-ло тап-ан чу - ка рум дум дум



мла - ди мо-ми и ер - ге - ни до две о - ра ви - ат

Зурли трештат на сред село
тапан чука рум, дум, дум,
млади моми и ергени
до две ора вијат.

Оздол иде стар бел дедо,
засукал мустаки
право тргна на орото,
и он да се фати.

Го здогледа баба Неда
за рака го фати,
каде одиш старо аро,
оро да им грдиш.

Zumarja tingëllon në mes të fshatit
Lodra bie rum dum dum
Vasha të reja beqare
Nga dy valle vallëzojnë.

Nga poshtë vjen një gjysh i vjetër
I bardhë dhe me mustaqe
Drejt e në valle nxitoi
Edhe ai që të vallëzojë

E shikoi gjyshja Neda
E kapi për dore
Ku po shkon ti ore plakush
Vallen t'ua shëmtosh.



Detyra:

1. Emërto llojin e ansamblit koral.
2. Cilët elemente folklorike i dallon nga kjo pjesë (emërto instrumentin popullor të cilin e imitojnë zërat e paraqitura në këtë kompozim)?

Këngë

(sipas veshit)

D. Masevski - I. Markovski – J. Jovanov



Kjo këngë,
О-ста-на-а са-мо--
О-ста-на-а дни-те
Kjo këngë

është një këngë
на-де-жи-те го-ли---
о-са-ме-ни таж-ни
për mua

me plot dashuri,
ра-на-та што клу-ка---
бес-крај-ни-те но-ќи---
dhe për ty,

ср-це-то што бо-ли
Kjo këngë

Во
не-спо-кој-ни праз-ни
le të ringjall

ср - це-то но - сев
dashuri,

ед-на ро-за си-на,
Dashuri

но по-ми-на не - кој
ndërmjet

ро-за-та ја ски-на. Во
njerëzve

ро-за-та ја ски-на.
të botës,

На на на
Na na na

на на на
na na na

на на на на на на на на на на
na na na na na na na na na na

на на на на на на
na na na na na na

Interpreto këngën vetëm me vijën e sipërme ose vijën e poshtme melodike që fillon nga refreni.

Todor Skallovski

Todor Skallovski është kompozitor maqedonas. Ai dha një kontribut shumë të madh për zhvillimin e jetës muzikore dhe kulturës në përgjithësi, të Maqedonisë. Me një dëshirë dhe fuqi shumë të madhe, ai me shumë sukses punoi jo vetëm si kompozitor por edhe si dirigjent koral, dirigjent orkestral si dhe ishte një organizator i shkëllyer i cili e pasuroi jetën muzikore në vendin tonë.



Ndërmjet dy luftërave botërore, u paraqit grupa e parë e kompozitorëve profesionistë maqedonas: Zhivko Firfov, i cili është themeluesi i shkencës së folklorit muzikor maqedonas, Stefan Gajdov, Trajko Prokopiev, Petre Bogdanov Koçko dhe Todor Skallovski.

Pas formimit të shtetit bashkëkohorë maqedonas, ky grup i muzicentëve mori pjesë në shumë aktivitete kulturore – muzikore si p.sh. formimi i institucioneve muzikore: Filharmonia maqedonase (1944), dhe Opera dhe baleti maqedonas (1948).




Skallovski, Prokopiev, P.B.
Koçki Gajdov

Todor Skallovski u lind në Tetovë (1909 – 2004), në një familje ku melosi nacional ishte thellë i mbjellur në zemrat e çdo antari të familjes së tij.

Prindërit e tij ishin kultivues dhe interpretues të këngëve popullore, dhe për këtë arsye, në krijimtarinë e kompozitorit Todor Skallovski, dominant është orientimi folklorik.

Në opusin e tij krijues, prezentë janë kompozimet për orkestër, vepra kamertale, vera vokalo – instrumentale, këngë solo, kompozime korale për kore të përzierë, kore të femrave dhe të fëmijëve, si dhe vepra të tjera muzikore.



A e keni të njohur?

Me kompozimin “ Valle maqedonase “ , Todor Skallovski e gjen rrugën deri tek nënqielli nacional maqedonas, kurse nëpërmjet pasurisë së folklorit muzikor, ai thellë prek në shpirtin e popullit të tij duke e përdorur ritmin karakteristik të valles maqedonase të ashtuquajtur “ Teshkoto”.

Ninullë Sharri

(këngë për zë dhe piano)

Kënga për zë dhe percjellje(piano) është kompozim vokalo – instrumental që i dedikohet zërit dhe që ka percjellje të një ose më tepër instrumenteve ku ndonjëherë mund të ketë edhe percjellje orkestrale. Nëpërmjet kësaj forme muzikore, kompozitorët me gjuhën e tyre muzikore e shprehin përmbajtjen e tekstit poetik. Këtë zhanr të interpretimit vokal , mund ta realizojë zëri i fëmijut, femrës ose zëri i mashkullit. Sipas formës mund të jetë:

- strofike – ku në një melodi të njëjtë këndohet tekst i ndryshëm;
- e rikomponuar – ku për çdo strofë të tekstit këndohet melodi e re.

Njëra nga këngët solo më të suksesshme dhe më të interpretuara të kompozitorit Todor Skallovski, që është krijuar për zë dhe piano, është “ Ninulla e Sharrit”.

Bazamenti tingëllor i këtij kompozicioni është kënga popullore me tiparet e saja, të cilën kompozitori e mësoi nga nëna e tij. Shumë vite me radhë, kompozitori i barti me vete kujtimet nga fëmijëria, çastet të cilat i kaloi me nënën e tij, emocionet dhe ndjenjat e saja të pasura me ndjesi muzikore. Për krijimin e kësaj ninulle kompozitori thotë:

“ Nëna ime ishte shumë fetare, por edhe një grua shumë muzikale me një zë shumë të bukur. Kështu, ajo shpeshherë më vinte në gjumë duke më kënduar këngë të llojllojshme duke filluar nga ninullat e fëmijëve, deri tek këngët elegjiake, këngëve të vjetra qytetare dhe atyre heroike. Ajo shpeshherë interpretonte edhe lutje fetare e sidomos në periudhat e festave fetare. Zëri engjëllor i nënës sime, më vinte në gjumë me ndonjë këngë të lehtë. Ky ishte edhe inspirimi im për kompozimin të titulluar “ Ninullë Sharri” – thotë Skallovski.




Detyrë:

1. Gjeje llojin e veprës muzikore sipas mënyrës së interpretimit.
2. Përcakto karakterin e kësaj veprë muzikore.

Përforcim i llojeve të zëreve

Aktivitete projektuese



Përforcimi i llojeve të zërave

Organizimi i aktiviteteve projektuese

Arsimtari – koordinator, e ka të nevojshme që ti aplikojë këto mënyra në aktivitetin projektues:



Faza e I – rë : Planifikimi dhe organizimi

Njohje mbi aktivitetin projektues: përforcimi për llojet e zërave (femëror, mashkullor dhe fëmijëror. Hulumtim i interpretuesve që i përkasin zhanreve të ndryshme muzikore);
Përcaktimi i grupeve të nxënësve sipas dëshirës dhe afiniteteve të tyre.



Faza e II – të: Hulumtimi dhe përgatitja

Mbledhja e materialeve (fotografi, audio incizime, dorëshkrime nga intervjutë, video incizime e të tjera);
Rregullimi dhe përgatitja e materialeve (marrëveshje për përpunime, selektim dhe rregullim).



Faza e III – të : Përgatitja për punën finalizuese

Përcaktimi i modelit për prezantim;
Rregullimi teknik;
Rregullimi estetik.



Faza e IV – të: Prezantimi

Prezenti gojor me audio incizime;
Prezenti me hamer ose audio incizime;
Video prezantim në Power – Point, me prapavijë muzikore;
Lloje tjera të prezantimit sipas dëshirës së nxënësve.



Faza e V – të: Rezultate të pritura

Prezantim jo mjaft i suksesshëm;
I suksesshëm;
Prezantim shumë i suksesshëm.

Në vlerësimin e prezantimit, nxënësit i japin mendimet e tyre.

O, sole mio!

Kanconë italiane

“O, sole mio” shpeshherë emërtohet edhe si këngë napolitane. Këngët napolitane janë shkruajtur për garat vjetore të krijimeve të këngëve, dhe janë mbajtur në qytetin italian Napoli. Kjo traditë daton që nga viti 1830, fillimisht në përbërje të festivalit “Festival of Piedigrotta”.

O, sole mio – n e ka kompozuar Eduardo Di Kapua (Eduardo Di Capua), në vitin 1898, me tekst të poemës së Xhovani Kapuro.



Trio e tenorëve

*Che bella cosa na jurnata 'e sole,
n'aria serena doppo na tempesta!
Pe' ll'aria fresca pare già na festa...
Che bella cosa na jurnata 'e sole.
Ma n'atu sole
cchiù bello, oje ne'.
O sole mio
sta 'nfronte a te!
O sole, O sole mio
sta 'nfronte a te!...sta 'nfronte a te!
Quanno fa notte e 'o sole se ne
scenne, me vene quase 'na malincu-
nia; sotto 'a fenesta toia restarria
quanno fa notte e 'o sole se ne
scenne.
Ma n'atu sole*

Përkthimi i tekstit origjinal “O, sole mio”

Sa gjë e bukur është dita me diell,
Qielli i pastër pas stuhisë, ajri i pastër,
Dhe argëtimi veç më ka filluar.
Sa gjë e bukur është dita me diell.
Por dielli tjetër që është edhe më i ndritshëm
Është dielli im që e shoh në fytyrën tënde.
Dielli, dielli im është dielli yt.

Kur mbrëmja vjen dhe dielli ka perënduar,
Filloj që të ndjem i zymtë,
Dotë kisha qëndruar pranë dritares tënde,
Kur nata dhe dielli kanë perënduar,
Por dielli tjetër që është edhe më i ndritshëm
Është dielli im që e shoh në fytyrën tënde.
Dielli, dielli im është dielli yt.



Mbaj në mend!

1.Kancona është melodi popullore italiane (baladë). E ka prejardhjen nga pjesa jugperëndimore e Francës, e lidhur në mediteran me Italinë.

Tri tenorët e njohur: Luçijano Pavaroti, Plaçido Domingo dhe Hose Kareras, e përbëjnë trion më të njohur të tenorëve të të gjitha kohërave. Për këtë dëshmojnë dy rekorde të Ginisit: Pavaroti për më shumë kthyerjeve në skenë (165) herë, si dhe për album më të shitur klasik, së bashku me Plaçido Domingon dhe Hose Kareras.

Në vitet e 90 – ta , ekipimi i Pavarotit me Domingon dhe Kareras, u bë një fenomen muzikor dhe shembull pas të cilëve dolën edhe “ tri tenorët irlandez “ dhe ansamble tjera të vogla të muzikës vokale.




Plaçido Domingo



Luçijano Pavaroti



Hose Kareras



A e keni të njohur?

Paraqitjet e përbashkëta skenike të tri tenorëve të njohur, përveç publikut (dëgjuesve), ishin kënaqësi e veçantë edhe për vetë interpretuesit. Për këtë arsye, në një rast Plaçido Domingo tha: “Në disa momente të koncerteve tona, mundoheshim që të mos harrojmë se jemi në koncert para publikut i cili na pagueu”.

Nga viti 1951,në qytetin italian San Remo, mbahet festivali i kanconës italiane i ashtuquajtur “ San Remo”.



Detyrë:

1. Gjeje llojin e veprës muzikore sipas mënyrës së interpretimit.
2. Çfarë zëre e realizojnë kompozimin?

Llojet e masave kohore

▶ Le të rikujtohem:

Masa kohore është pjesë e vogël e kompozimit muzikor i cili përmban pjesë të forta (të theksuara) dhe pjesë të buta (të patheksuara).



Masat kohore ndërmjet veti janë të ndara me vija vertikale, të quajtura si vija të masave kohore.




Aktivitete:

1. Recito me saktësi, tekstin e ushtrimit ritmik dhe jepi aksentin e duhur fjalëve.

Nat' e qetë, yjet ndriçojnë'

Metri 2/4



Thekset e fjalëve që përdoren në fjalët e lëmisë së literaturës, në muzikë, përputhen me pjesët e forta të masës (në pjesët e theksuara).

Për shkak të radhitjes së pjesëve të masave kohore të forta dhe të buta, në shembullin e lartshënuar ritmik, ritmi është shënuar në metrin 2/4.

Ky është metër i rregullt binar, kurse pjesët e masës zgjasin nga një katërshe (një kohë).


() = në një të rahur, (një kohë.)



Mbaj në mend!

Metri binar 2/4, për njësi matëse bazë, e ka notën katërshe.

Përmban dy kohë të masës dhe lexohet në dy të rrahura (dy kohë).



— pjesa e theksuar e masës
 ~ pjesa jo e theksuar e masës

Metri i përbërë i 5/8



Aktivitetet!

1. Recito me saktësi, tekstin e ushtrimit ritmik dhe jepi theksin e duhur fjalëve dhe lexo në dy të rrahura.

Er – dhi	lej – le – ku	një lajm	na – so – lli
Er – dhi	pran – ve – ra	sti – na	e bu – kur
Ми - ли	де - чи - ња,	штр - кот	до - ле - та.
Но - вост	до - не - се,	дој - де	про - лет - та.

Ky tekst letrar është shënuar me vlera të notave tetëshe në metrin e 5/8.


Er – dhi	lej – le – ku	një lajm	na – so – lli
Er – dhi	pran – ve – ra	sti – na	e bu – kur
Ми - ли	де - чи - ња	штр - кот	до - ле - та.
Но - вост	до - не - се	дој - де	про - лет - та.
Koha e parë	Koha e dytë	Koha e parë	Koha e dytë

Në metrin e 5/8 – ve njësia matëse bazë është nota tetëshe.




Metri i 5/8 – ve përmban dy kohë në kuadër të masës.

Njëra kohë e masës përmban dy nota tetëshe,
kurse koha tjetër e masës
përmban tri tetëshe.



Metri më shpesh i përdorur



или

Metri më rallë i përdorur



Mbaj në mend !

Në metrin e 5/8- tave, njësia matëse bazë është nota tetëshe.


Përmban dy kohë në kuadër të masës dhe lexohet në dy të rrahura.

Përdorimi i metrit 5/8 – tave në ushtrime ritmike dhe melodike

Ushtrim ritmik



Ushtrim melodik nr. 1



Ushtrim melodik nr.2



Detyrë:

1.Krahaso ritmin e ushtrimit ritmik dhe ushtrimit melodik nr.1.



Aktivitete:

Përcille ritmikisht ushtrimin melodik nr. 1 dhe nr. 2 nëpërmjet leximit.

Më trego , Katinka

Popullore



Ка - жи ми ка - жи Ка - тин - ке
Më trego, më trgo Katinka,

ко - ја ли ве - чер да - дој - дам
Në cilën natë të vij,

Hej, haj, sëmurë jam unë,
Хеј, хаж, бо - лен сум јас

без бо - лест бо - лен си лег - нав нав
Pa sëmundje, i sëmurë jam.

Која ли вечер да дојдам,
пред врата да ти застанам.

Në cilën natë të vij
Para dere të të pres

Рефрен:
Хеј, Хаж
болен сум јас.
Без болест
болен си легнав.

Refren:
Hej, haj,
sëmurë jam unë,
Pa sëmundje,
i sëmurë jam.



Detyrë:

1. Dëgjo vallen “ Optan – toptan” dhe pastaj gjeje ritmin e saj.




Aktivitete:

1. Zbato ritmin e valles nëpërmjet vallëzimit.

Në ditën e Pashkëve jam dashuruar


Përpunimi i kompozimit të Xhina Papas Xhoksi “ Në ditën e Pashkëve jam dashuruar”.

Në këtë ditë të madhe,
Zot, ti më jep ndihmë;
Më trego se ku ta gjej,
Zot, ti më jep ndihmë,
Më trego se ku ta gjej.



Lambe Alabakovski

Kaq shumë njerëz nuk kam parë,
Të mbledhur si në këtë ditë,
Zot, ti më jep ndihmë,
Më trego se ku ta gjej,
Zot, ti më jep ndihmë,
Më trego se ku ta gjej.



Xhina Papas Xhoksi dhe Llambe

Gajdat fuqishëm le të luajnë,
Të dëgjohen deri në qiell,
Unë me këngë ju thërras,
Kështu ate do ta gjejme.



Ti populli im,
Kudo që ti të ndodhesh
Dashuria e Zotit gjithçka do të mund
Të gjitha shpresat do ti dëgjoj,

Unë me këngë ju thërras,
Kështu atë do ta gjejme,
Unë me këngë ju thërras,
Kështu atë do ta gjejme.



Aktivitete:

1. Përshkruaj një përjetim tëndin nga një festë fetare.

Shën Kirili dhe Metodij (pas zërit)



Ми - на - а ве - ко - ви дол - ги и мно - гу у - ште ќе ми - нат,
Kaluan shumë shekuj, dhe shumë të tjerë do të kalojnë,
ва - ши - те и - ми - ња све - ти ни - ко - гаш не - ма да зги - нат.
Emrat e juaj të shenjtë, kurë nuk do t'i harrojmë,
По - свет - ли ли - ко - ви за нас, не - ма под не - бе - сен свод,
Fytyra më të ndritura për ne, nuk do të ketë nën këtë qiell,
а - збу - ка ви - е му да - дов - те на це - ли - от слав - јан - ски род.
Alfabetin ju i'a dhatë, tërë popullit tonë.

Вие солунските браќа
учители наши први,
народот вие го учевте,
напред со книга да врви.

И како сонцето светло
вечно од небо да сјае,
така пред народот славјански,
делото ваше ќе трае.

Ju, Mësues të Selanikut,
Mësuesit tanë të parë,
Popullin ju e mësuat,
Me librat e juaj të shenjtë.

Dhe sikur dielli i ndritshëm,
Që shkëlqen përjetësisht në qiell,
Ashtu edhe veprat emjuaja,
Të përmenden ndër popullin tonë.



Detyrë:

1. Zbato interpretim të rregullt vokal , me përdorimin e tempos dhe dinamikës së duhur.

Wolfgang Amadeus Mozart

Wolfgang Amadeus Mozart (Wolfgang Amadeus Mozart 1756 – 1791) , është njëri nga kompozitorët më të dalluar dhe më të rëndësishëm dhe me përmasa botërore, në muzikën klasike - serioze. U lind në Salzburg të Austrisë.



Me epitelin “ mrekulli nga fëmija”, u emërtua veç kur i kishte disa vjetë. Babai i tij Leopold Mozarti, e mësoi të luajë në violinë dhe piano dhe dha një kontribut shumë të madh në zhvillimin e karrierës së tij.

Më vonë do të pasojnë koncertet shumë të suksesshme që do t'i realizojë në tërë Evropën dhe në këtë mënyrë ai do të krijojë një famë shumë të madhe.

Ishte një artist i vërtetë, me energji të spikatur të artistit, me dëshirë dhe ambicie për punë.

Krijimtaria e tij muzikore është shumë e gjerë edhe pse jetoi shumë pak vite – vetëm 35. Shkruajti shumë simfoni, koncerte për piano, violinë, pjesë kamertale, sonata , rekueme, e të tjera. Numri i simfonive të tij është 41.

Ka pasur dëshirë që të udhëtojë në Londër, dhe ky mendim e motivoi që ti shkruaj simfonitë e tij nr. 39, 40 dhe 41.

Simfonia e tij nr. 40 , e ashtuquajtur si simfonia e madhe në g – mol, është njëra nga veprat më të njohura dhe më të përdorura orkestrale, e cila është e ndërtuar nga katër kohë (pjesë).

Koha e tretë (III) e kësaj simfonie është Menuet. Në veçanti të len përshtypje dhe që është shumë e dalluar, tema e parë e menuetit. E njëjta temë paraqitet edhe te fillimi i operës “ Don Zhvani”, kur dona Ana e gjen babain e saj të vdekur.



Mbaj në mend!

1. Simfonia është vepra më e madhe instrumentale, e cila interpretohet nga orkestra, dhe është e përbërë prej katër kohëve. U paraqit në shekullin e XVII – të , por zhvillimin e saj më të madh do ta arrijë në periudhën e klasicizmit (shekulli i XVIII).



Aktivitete:

Hulumto për jetën dhe krijimtarinë e kompozitorit V.A.Mozart , duke e përdorur IKT – në.

Simfonia nr. 40 - g – mol

Menuet

(Koha e III – të)

Në shekullin e XVIII – të, menueti paraqitet si pjesë përbërëse e formave ciklike muzikore – kompozimeve të mëdhaja instrumentale (simfonia, sonata). Menueti zakonisht vendoset si koha e tretë e formave ciklike të lartpërmendura.

Menueti është valle e vjetër franceze, që daton nga shekulli i XVII – të. Është i ndërtuar në masën e $\frac{3}{4}$ - tave, dhe karakterizohet me tempo mesatare. Si valle, përdoret për ahengjet dhe argëtimet e ndryshme të aristokratëve. Është vallëzuar në çifte, me hapa të vogla, si një valle solemne nëpër sallonet he oborret e aristokratëve. Karakteristike për këtë lojë janë lëvizjet e ngadalta dhe gracioze të trupit, eleganca dhe ndjeshmëria.

Mocarti, ishte njëri nga kompozitorët që i përkisnin periudhës së klasicizmit, i cili e përdori shumë këtë valle të vjetër franceze , në veprat e tija. Mocarti, në pjesën e parë të menuetit e simbolizon shoqërinë e atëhershme aristokrate. Ritmi energjik i valles, si dhe tonete ulëta, i'a japin qetësinë pjesës.



Aktivitete:

1. Përjetimin e muzikës së dëgjuar, shprehe nëpërmjet valles me ritëm të menuetit.




Detyrë:

1. Gjeje tempon dhe dinamikën e menuetit.

Përforcim për llojet e ansambleve

Aktivitet projektues



Përforcim për llojet e ansambleve vokale

Organizimi i aktiviteteve projektuese

Arsimtari – koordinator, duhet që t'i zbatojë këto udhëzime në aktivitetin projektues:



Faza e I – rë: Planifikimi dhe organizimi

Njohja me aktivitetet projektuese: përforcim për llojet e ansambleve vokale (Fëmijërore, femërore, mashkullore dhe të përziera).
Hulumtimi i ansambleve në zhanre të ndryshme të muzikës;
Përcaktimi i grupeve të nxënësve , sipas mundësisë , të zgjidhen për nga dëshira dhe afinitetet e nxënësve.



Faza e dytë: Hulumtimi dhe përgatitja

Mbledhja e materialeve (fotografi , audio incizime, të dhëna nga intervjutë, video incizime, etj.);
Rregullimi dhe përgatitja e materialeve (marrëveshje për përpunim, selektim dhe rregullim).



Faza e III – të: përgatitja e punës finalizuese

Përcaktimi i modelit për prezantim;
Rregullimi teknik;
Rregullimi estetik.



Faza e IV – të: Prezantim

Prezantim gojor me audio incizime;
Prezantim me hamerë dhe audio incizime;
Video prezantim në Power Point, me prapavijë muzikore;
Lloj tjetër prezantimi sipas dëshirës së nxënësit.




Faza e V – të: Rezultatet e pritura

Prezantim jo shumë i suksesshëm;
Prezantim i suksesshëm;
Prezantim shumë i suksesshëm.

Në vlerësimin e prezantimit, nxënësit i japin edhe mendimet e tyre.

Festivalet muzikore




Eurovizioni

Eurovizioni është festival muzikor, i cili mbahet që nga viti 1956. Ky festival emitohet në shemë medime televizive si në vendin tonë ashtu edhe jashtë vendit dhe Europës. Ka karakter garues. Mbahet për çdo vit në shtetin fitues.

Xhaz festivali i Shkupit

Fillimet e festivalit xhaz te Shkupit, datojnë që nga viti 1982. Edhe pse në këtë festival promovohet një lloj i muzikës i cili në dukje të parë të jep përshtypjen e një muzike të huaj – jo e vendit, e largët nga kultura dhe tradita e saj, përsëri ky festival në vete tërheq një numër të madh të auditoriumit. Ka reputacionin e një festivalit prestigjioz jo vetëm në Maqedoni, por edhe në tërë Ballkanin si dhe në Europë.



Taksirat – Shkup


Bëhet fjalë për një festival i cili promovon muzikë ballkanike - rok, ku marrën pjesë një numër i madh i muzicentëve ballkanik. Për herë të parë u mbajt në Shkup në vitin 1999. Këtë festival me shumë ëndje e ndjekin një numër i madh i adhuruesve të këtij zhanri muzikor.

Mak Fest - Shtip

Festivali Makfest ekziston që nga viti 1986 dhe për çdo vit, tradicionalisht mbahet në Shtip. Është një ndër festivalet shumë të njohura dhe domethënëse për muzikën maqedonase ku marrën pjesë një numër i madh i këngëtarëve dhe muzicentëve, kryesisht maqedonas.



Ohri fest – Trubadurët e Ohrit




Ohri është njëra nga vendet më të mëdhaja verore të manifestimeve muzikore, si edhe të muzikës zbavitëse. Këtë manifestim të këngës zbavitëse e transmetojnë në mënyrë direkte TV stacionet nga Europa, Australia dhe SHBA – ja. Shpallet konkursi ndërkombëtar për kompozime të ndryshme dhe bëhet përzgjedhja e këngëve pjesëmarrëse të festivalit.

Manifestime të rëndësishme muzikore

Vera e Ohrit

Festivali Vera e Ohrit u themelua në vitin 1961. Ngjarja e parë oficiale e këtij festivali ishte koncerti i këngëtares operistike Ana Lipsha Tofoviq, në vitin 1961. U kurorëzua me një pamje të lartë ndërkombëtare, si një manifestim me vlera shumë të larta artistike. Për këtë arsye, nga viti 1994, festivali është anëtar i rregullt i asociacionit Evropian të festivaleve.

Për çdo vit, tradicionalisht mbahet në muajin qershor dhe gusht. Mbuluesi i festivalit është Kryetari i Republikës së Maqedonisë. Përgjatë viteve të kaluara, në këtë festival kanë marr pjesë një numër shumë i madh i artistëve muzikantë të vendit dhe të huaj si dhe një numër i madh i ansambleve teatrale.



Netët operistike të majit

Manifestimi muzikorë – skenik, Netët operistike të majit, për herë të parë u mbajt në vitin 1972, dhe paraqet njërën nga ngjarjet më të frekuentuara muzikore. Netët operistike të majit realizohen në hapësirat e OBM ku marrin pjesë një numër i madh i shfaqjeve operistike dhe të baletit. Në këtë manifestim, marrin pjesë një numër i madh i artistëve- muzikantë të vendit dhe jashtë vendit.

Ditët e muzikës Maqedonase

Ditët e muzikës maqedonase paraqesin një nga ngjarjet më të mëdhaja muzikore në Maqedoni dhe një mundësi ku proklamohet krijimtaria e kompozitorëve të shumtë maqedonas.

Ky manifestim muzikor, për herë të parë u mbajt në vitin 1977. Në koncertet e shumta promovohen emrat e kompozitorëve të rinj të skenës së muzikës klasike si dhe të kompozitorëve maqedonas që i kemi përmendur më herët.

Si interpretues janë emra të rinj, të spikatur dhe të devotshëm maqedonas.



Rekomandim:

Përzgjedhjen e veprave muzikore bëni sipas dëshirës suaj.

Gazmend i hareshëm

(sipas veshit)



Ca - ma se - dam do - ma, и на - та - же - на,
Ri e vetme në shtëpi, dhe pak si e pikëlluar

Ca - mo mis - lam што да нап - ра - вам.
Veç mendoj se çka të bëj,

У - чи Ма - ри - ја са - мо се пов - то - ру - ва,
Mëson Marija, dhe çdo gjë përsërit,

до - ма в'шко-ло ниш - то но - во не се слу - чу - ва.
Në shkollë dhe shtëpi, Asgjë nuk i ndodh.

Лу - да жур - ка пра - вам,
Mbrëmje të hareshme do të bëj,

лу - да за - ба - ва,
Gazmend të hareshëm,

сме - а и гра, ша - ла,
Me shumë befasia dhe me plot çudira,

лу - да за - ба ва,
Me shumë befasia dhe me plot dëshira.

Përmbajtja :

Së bashku mundemi:.....	4
Dragan Shuplevski	6
Kapriçio maqedonase.....	7
Zgjerimi i vëllimit të toneve	8
Fa2 – f2	9
Sol2 – g2	10
Përdorimi i notës mi2 në këngë	11
Përdorimi i notës fa2 në këngë.....	12
Përdorimi i notës sol2 në këngë	13
Shkallët tonale dur	14
Mënyra e krijimit të shkallëve dur me dieza.....	15
Shkalla G – dur.....	16
Ushtrime melodike në shkallën G – dur.....	17
Nota dhe pushimi i notës gjashtëmbëdhjetëshe.....	18
Vajti Rumena pas ujit të ftohtë.....	20
Përdorimi i notës dhe pushimit të notës gjashtëmbëdhjetëshe.....	21
Krijimtaria bashkëkohore maqedonase.....	22
Risto Avramovski.....	23
Elelica – pepelica (për kor fëmijësh).....	24
Dashuri vëllazërore.....	25
Shkallët tonale mol.....	26
Lloji natyror i shkallës mol – shkalla e – mol.....	27
Lloji harmonik i shkallës mol- shkalla e – mol.....	28
Lloji melodik i shkallës mol – shkalla e – mol	29
Aplikimi i shkallës e – mol natyror, harmonik dhe melodik	30
Ushtrime melodike në shkallën G – dur dhe e – mol.....	31
Fjalja muzikore.	32
Periodha.....	33
Aplikimi i tërësive muzikore në këngë... ..	34
Fjalja dhe periodha.....	35
Këngë tradicionale angleze për Krishtlindjet.....	36
Kështë për Krishtlindjes.....	37
Mënyrat e interpretimit muzikor... ..	38
Muzika vokale dhe llojet e zërave.. ..	39
Zërat e fëmijëve.....	40
Zërat e femrave.....	41
Interpretuese vokale femërore.....	42
Zërat e meshkujve.....	43
Interpretues vokal mashkullor.....	44
Ansamble vokale.....	45
Kori dhe këndimi koral.....	46
Ansambl i vokale – Kori.....	47
Kori i fëmijëve.....	48
Stojan Stojkov.....	49
Këngë Maji.....	50
Kori i femrave.....	51

Trajko Prokopiev.....	52
Vuajtje.....	53
Kori i meshkujve.....	54
Karl Marija von Ueber.....	55
Kori i gjuetarëve nga opera “ Shigjetari magjik”	56
Kori i përzier.....	57
Dragan Shupleski “ Rum ,dum ,dum”.....	58
Këngë.....	59
Todor Skallovski.....	60
Ninullë Shari.....	61
Përforcimi për llojet e zërave (aktivitete projektuese).....	62
Përforcimi për llojet e zërave (organizimi i aktiviteteve projektuese).....	63
O, sole mio (kanconë italiane).....	64
Llojet e masave kohore	66
Metri i 5/8 – tave.....	67
Aplikimi i metrit 5/8 – tave në ushtrime melodike dhe ritmike.....	68
Këngë	69
Në ditën e Pashkëve jam dashuruar	70
Sh. Kirili dhe Metodij	71
Wolfgang Amadeus Mozart.....	72
Simfonia nr. 40 – g – mol - Menuet	73
Përforcimi për llojet e zërave (aktivitete projektuese).....	74
Përforcimi për llojet e zërave(organizimi i aktiviteteve projektuese).....	75
Festivalet muzikore	76
Festivalet e rëndësishme muzikore	77
Gazmend i hareshëm.....	78